



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 325/2025

Datë: 30 prill 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 3 dhe 9 të Rregullores Nr. 04/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Themelimin dhe Funkcionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, nenit 3 paragrafi 5 të Rregullores për Themelimin dhe Funkcionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, në takimin e mbajtur më datë 30 prill 2025, nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Z. Kujtim Munishi, prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë caktohet Koordinator Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik me mandat tre (3) vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat pas vlerësimit pozitiv të punës.
2. Gjatë kohës së ushtrimit të detyrave të Koordinatorit Kombëtar, z. Kujtim Munishi, e pezullon detyrën e prokurorit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë deri në përfundim të mandatit të Koordinatorit Kombëtar.
3. Obligohet z. Munishi që detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Kombëtar ti ushtrojë konform legjislacionit në fuqi.
4. Z. Kujtim Munishi pranon pagën dhe beneficionet që dalin nga marrëdhënia e punës si prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë edhe gjatë mandatit si Koordinator Kombëtar.
5. Prokurori i Shtetit do të sigurojë hapësirë pune për Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik.
6. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Kujtim Munishi, prokuror në PTH Prishtinë;
- U.D. Kryeprokurorit të Shtetit;
- Kryeprokurorëve të prokurorive të R. së Kosovës;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.